




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ZUBIN POTOKUT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Zubin Potokut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Zubin Potokut (K.ZP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Zubin Potokut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Dobësitë në përgatitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2023 ku ishin shfaqur gabime, pasaktësi dhe plotësi të informacionit financiar dhe jo financiar.
- C1 Komuna e Zubin Potokut në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV), në nenin 19 Raporti për pasuritë jo financiare, nuk i ka prezantuar pasuritë e blera kapitale gjatë viteve 2022 dhe 2021 në vlerë prej 495,552€ € dhe pasuritë nga vitet paraprake. Në anën tjetër, rrugët dhe toka nuk janë regjistruar në SIMFK. Te pasuritë nën 1,000€ nuk kishte regjistra kontabël në sistemin “e-pasuria” apo ndonjë platformë tjetër si dhe stoqet nuk kanë vlerë financiare në shpalosjet e PVF-ve.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Zubin Potokut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A1 Urdhërblertjet jo sipas rregullave financiare në vlerë prej 2,148€.
- B2 Komuna ende nuk mbledh të hyra nga taksat e pronës dhe lejet e ndërtimit dhe nuk ka miratuar rregullore të brendshme për tatimet, tarifat, taksat dhe ngarkesat për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Zubin Potokut.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Zubin Potokut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Zubin Potokut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Zubin Potokut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Zubin Potokut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF). Pas kërkesës sonë disa çështje të ngritura në PVF-të nuk janë korrigjuar. Gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e pasurive, subvencione, mallra dhe shërbime, paga, të hyrat, auditimi i brendshëm, pasqyrat vjetore financiare për vitin 2023 të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 7 rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Dobësitë në përgatitjen e PFV-ve

##### Gjetja

Sipas Rregullores së MF-së Nr.01/2017 për raportimin financiar vjetor të Organizatës Buxhetore, dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, PFV duhet të prezantojnë informata të verteta dhe të sakta.

Me rastin e rishikimit të PFV-ve kemi identifikuar gabimet e mëposhtme:

- Në pasqyrat kryesore nuk ishin prezantuar të dhënat financiare për vitet 2022 dhe 2021 në mënyrë që të ketë krahasueshmëri nëpër vite.
- Te neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare përkatësisht nga shënimi 2 deri 9 në tabela mungonin të dhënat financiare për dy vitet paraprake.
- Shënimi 5 Subvencione dhe transfere, buxheti final është prezantuar në vlerë 55,000€, sipas SIMFK-së duhet të ishte 80,000€ (vlera e rumbullaksuar);
- Shënimi 6 Shpenzimet kapitale, buxheti final në SIMFK në vlerë 154,000€ nuk është prezantuar;
- Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare, janë prezantuar vetëm vlera e ndërtesave për vitin 2023 në vlerë 71,065€, por në sistemin e SIMFK-së nuk i kanë të regjistruara pasuritë (toka, infrastrukturë rrugore, e të tjera), është vërejtur që në vitin 2022 dhe vitin 2021 janë realizuar pagesa për investime kapitale në vlerë totale 495,552€ (234,191€ dhe 261,361€) që nuk janë përfshirë në regjistra të pasurisë.
- Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 euro), nuk ka vlera financiare të prezantuara;

- Neni 19.3.3 Stoqet, nuk ka vlera financiare të prezantuara;
- Shënimi 9 Të hyrat jo tatimore, mungojnë të dhënat financiare në shpalosje për gjobat e lëshuara nga Policia e Kosovës që i takojnë Komunës si të hyra indirekte.
- Neni 16 Raport për të arkëtueshmet dhe neni 18 Detyrimet kontigjente nuk ka të dhëna komuna për ti prezantuar vlerat financiare.
- Te neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara, te neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara dhe neni 24 raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara për bartje në tabela mungonin të dhënat financiare për dy vitet paraprake.
- Te neni 25 Raporti për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave në tabela mungonin të dhënat jo financiare përkatësisht numri aktual i punëtorëve në fund vit për dy vitet paraprake.

Përgatitja e PFV-ve nga Komuna nuk ishte bërë në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 01/2017 për raportim financiar. Pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave gjatë auditimit. Komuna nuk ka marrë masa dhe nuk ka bërë korrigjimet e nevojshme.

Dobësitë lidhur me përgatitjen e PFV-ve po përsëriten në vazhdimësi. Çështjet e shumta për korrigjimin e tyre, siç janë listuar më lartë, tregojnë se sistemi i kontrollit të brendshëm mbetet në nivelin jo të duhur.

#### **Ndikimi**

Paraqitja e pasaktë dhe jo e plotë e informatave financiare në PFV, ka ndikuar në pa saktësi të të dhënave dhe ulë shkallën e besueshmërisë së shfrytëzuesit të synuar.

#### **Rekomandimi B1**

Kryetari duhet të shtojë kontrollet gjatë përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që për vitin 2024 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e lëshuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë kryer të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PFV-ve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja C1 - Mosregjistrim dhe mos shpalosje të pasurisë në PVF**

#### **Gjetja**

Rregullore e MF - Nr. 02/2013, neni 6, për menaxhimin e pasurive jofinanciare në organizatat buxhetore kërkon që secila organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe përditësojë një regjistër të pasurive jofinanciare që menaxhon. Regjistri duhet të mbahet veçmas për çdo aktiv dhe në formë të përmbledhur sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Rregullorja gjithashtu specifikon se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo-kapitale duhet të regjistrohet në e-pasuri.

Në PFV-të e vitit 2023 Komuna e Zubin Potokut, në nenin 19 Raport për pasuritë jo financiare, nuk i ka prezantuar pasuritë e blera kapitale gjatë vitit 2022 dhe viti 2021, në vlerë prej 495,552€ dhe pasuritë nga vitet paraprake. Në anën tjetër, rrugët dhe toka nuk janë regjistruar në SIMFK. Po ashtu, edhe pasuritë nën 1,000€ nuk ishin regjistruar në sistemin “e-pasuria” apo në ndonjë platformë tjetër. Kjo çështje është trajtuar edhe në auditimin e vitit 2021 dhe janë bërë rekomandimet e duhura, megjithatë nuk ka veprime konkrete në këtë drejtim përveç prezantimit të vlerës së kategorisë së ndërtesave.

Menaxhmenti i komunës ka deklaruar arsyet se komuna ende nuk ka nisur

procedurën e regjistrimit dhe vlerësimit të plotë të pronës që zotëron dhe për arsye të tjera administrative. Megjithatë, nga çështjet e përmendura rezulton se komuna nuk ka marrë me përgjegjësi menaxhimin e pasurisë.

**Ndikimi**

Mos regjistrimi i gjithë pasurisë e bën të vështirë për komunën menaxhimin dhe shfrytëzimin e suksesshëm të pronës për të marrë vendime racionale që do të ishin në interes të të gjithë qytetarëve. Gjithashtu, mungesa e të dhënave dhe informatave në regjistrat e pasurisë rezulton me përfaqësim të pasaktë në PFV.

**Rekomandimi C1**

Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherë duhet të siguroj që është vënë në përdorim sistemi e-pasuria. Po ashtu, për të pasur një evidencë të saktë të stoqeve, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€, duhet të regjistrohen.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Nxjerrja e urdhër blerjës pas pranimit të faturës

- Gjetja** Rregulla financiare Nr.01/2013, në nenin 15, përcakton që procedurat e blerjes duhet të fillojnë me një kërkesë për blerje, pastaj zotimi i mjeteve, pas të cilës duhet të procedohet me urdhër blerje, pranimin e mallit ose shërbimit, shpenzimi dhe më në fund pagesën e faturës.
- Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në dy (2) raste në vlerë totale 2,148€, urdhër blerjet ishin proceduar pasi kishte ardhur fatura.
- Kjo ka ndodhur për shkak të moszbatimit të procedurave ligjore për shpenzimet e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.
- Ndikimi** Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave mund të shkaktojë ndikim të mos kryerjes së obligimeve të faturuara në kohë, duke çuar në rritjen e detyrimeve të papaguara, që në fund do të shkaktojnë probleme për buxhetin e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurohet që nxjerrja e urdhër blerjeve bëhet para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohet rritja e detyrimeve të pa paguara.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B2 - Moszbatimi i ligjit për mbledhjen e të hyrave

- Gjetja** Neni 2 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme thekson qartë se çdo organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronë të paluajtshme. Gjithashtu, ligji nr. 04/L-110 për Ndërtimin në nenet 1 dhe 2 përcakton qëllimin e lëshimit të lejeve të ndërtimit.
- Komuna ende nuk filluar me mbledh të hyra nga taksat e pronës dhe lejet e ndërtimit dhe nuk ka miratuar rregullore të brendshme për tatimet, tarifrat, taksat dhe ngarkesat për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.
- Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ende nuk ka krijuar politika të zbatimit të ligjit dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për mbledhjen e të hyrave nga këto aktivitete që kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit komunal.
- Ndikimi** Mos zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimit në pronë, lejeve të ndërtimit, tarifave dhe taksave të tjera nga Komuna pasqyron një qasje jo serioze ndaj zbatimit të kërkesave ligjore në këtë fushë. Kjo ka ndikuar në një shkallë të ulët të realizimit të të hyrave si dhe pamundëson financimin e projekteve nga ky burim i të hyrave.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve për të mbledhur të hyrat e tatimit në pronë dhe lejeve ndërtimore për të siguruar fonde nga këto të hyra. Në të njëjtën kohë, Kryetari duhet të fillojë iniciimin për hartimin e Rregullores për tatimet, tarifrat dhe taksat, si kosto e shërbimeve komunale.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje është 705,494€, është shpenzuar 100%.

#### Çështja B3 - Mungesa e dëshmive për vijueshmëri në punë

##### Gjetja

Sipas Nenit 9 pika 2 të Rregullores 07/2022 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publikë, “Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni.

Komuna ende nuk përdorë evidencë elektronike për të punësuarit për vajtje/ardhje në punë, apo lista në të cilat nënshkruhen punonjësit për ta dëshmuar prezencën e tyre në punë.

##### Ndikimi

Mungesa e evidencave për prezencën në punë, paraqet kontroll të dobët mbi menaxhimin e stafit dhe mundësi për pagesën e parregullt apo fiktive, të zyrtarëve që nuk respektojnë orarin.

##### Rekomandimi B3

Kryetari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronikë

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje është 80,249€, ndërsa janë shpenzuar 52,037€ ose 64.84%.

### Çështja A2 - Mungesa e rregullorës për subvencione

#### Gjetja

Gjatë testimit të pagesave, kemi vërejtur se në tetë (8) raste janë dhënë subvencione për qytetarët në shumën nga 73€ deri në 350€. Këto pagesa janë ekzekutuar pa u bazuar në ndonjë rregullore specifike për subvencione. Pas kërkesës sonë për informacion përmes emailit, zyrtarët e komunës na konfirmuan se nuk ekziston një rregullore për dhënien e subvencioneve.

#### Ndikimi

Mungesa e një rregulloreje për dhënien e subvencioneve mund të çojë në shpërndarje jo të drejtë dhe të pa bazuar të fondeve publike. Kjo mund të rezultojë në mungesë të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe rrezik të lartë për abuzime dhe keqpërdorime të fondeve. Pa një rregullore të qartë dhe të mirëpërcaktuar, nuk ka një kornizë ligjore që garanton që subvencionet janë dhënë në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me qëllimet e politikave publike.

#### Rekomandimi A2

Kryetari të hartojë dhe të miratojë kuvendi një rregullore të qartë dhe të plotë për dhënien e subvencioneve. Kjo rregullore duhet të përfshijë kriteret e kualifikimit, procesin e aplikimit dhe vlerësimit, si dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e përdorimit të subvencioneve. Implementimi i një rregulloreje të tillë do të ndihmojë në sigurimin e transparencës dhe drejtësisë në shpërndarjen e fondeve publike dhe do të ulë rrezikun për keqpërdorim të tyre.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Nga organizatat buxhetore kërkohet që të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e tyre i nënshtrohen auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm ndihmon organizatën të arrijë qëllimet e saj duke aplikuar një qasje sistematike dhe disiplinore për vlerësimin e biznesit përmes planifikimit të punës së auditimit duke identifikuar dhe vlerësuar natyrën dhe nivelin e rrezikut të lidhur me çdo aktivitet të organizatës.

#### Çështja B4 - Mungesa e krijimit të njësisë së auditimit të brendshëm

- Gjetja** Ligji Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Rregulloret QRK Nr. 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, Neni 4 dhe 5 përcaktojnë funksionin dhe mënyrën e themelimit të NJAB. Në bazë të Nenit 5. "Subjekti i sektorit publik i cili ka buxhet më pak se tre (3,000,000.00 €), funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtron përmes mënyrave tjera sipas nënparagrafëve 1.2, 1.3. dhe 1,4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje (themelimi i njësisë së përbashkët ose marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të auditimit nga një subjekt i sektorit publik ose kontraktimin e një shoqërie profesionale sipas kritereve të përcaktuara, me miratimin paraprak të MF-së).
- Komuna nuk është audituar gjatë vitit 2021 dhe nuk ka paraqitur kërkesë në MFPT për nevojat e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe as ka përdorur mjete të tjera për të kryer funksionin e auditimit të brendshëm, siç përcaktohet në nenin 4 të Rregullores së QKR-së. - 01/2019.
- Kjo është përsëritje vit pas viti, pasi që komuna nuk shprehë gadishmërinë që të vë në funksion aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Ndikimi** Mungesa e raporteve të auditimit të brendshëm çon në përsëritje të vazhdueshme të dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm, dhe menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje të identifikojë dobësitë e kontrollit dhe të përgjigjet në kohën e duhur për eliminimin e tyre.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet komunale i nënshtrohen auditimit të brendshëm për të pranuar një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>3,032,542</b>	<b>1,098,531</b>	<b>812,374</b>	<b>1,676,209</b>	<b>1,914,148</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	2,987,542	1,022,623	812,374	1,623,737	1,884,679
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	13,482	3,339
Të bartura nga viti i kaluar	0	0	0	38,990	26,130
Të hyrat vetanake	45,000	45,000	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	30,908	0	0	0

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 1,934,011€ ose 63.78%.

Diferenca mes buxhetit fillestar dhe atij final është rezultat i reduktimit të grantit të Qeverisë në vlerë prej 1,964,919€ dhe rritjes së donacioneve të jashtme në vlerë prej 30,908€.

Në vitin 2023, komuna ka shpenzuar 812,374€ ose 73.95% të buxhetit final që është një rënie prej 51.54% krahasuar me vitin 2022.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>3,032,542</b>	<b>1,098,531</b>	<b>812,374</b>	<b>1,676,209</b>	<b>1,914,148</b>
Pagat dhe mëditjet	1,519,699	705,494	705,494	1,083,842	1,268,883
Mallrat dhe shërbimet	490,897	156,008	54,313	258,065	281,431
Komunalitë	50,000	2,030	529	11,141	16,582
Subvencionet dhe transferet	91,104	80,249	52,037	88,970	85,890
Investimet Kapitale	880,842	154,750	0	234,191	261,361

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë buxhetore janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje është 705,494€, krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 814,205€, dhe është shpenzuar 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime është 156,008€, krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 334,889€, ndërsa janë shpenzuar 54,313€ ose 34.81%.
- Buxheti final për komunalitë është 2,030€, krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 47,970€, ndërsa janë shpenzuar 529€ ose 26%.
- Buxheti final për subvencionet dhe transferet është 80,249€, krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 10,855€, ndërsa janë shpenzuar 52,037€ ose 64.84%.
- Buxheti final për investime kapitale është 154,750€, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 726,092€, dhe nuk janë realizuar shpenzime kapitale.

Si pasojë e situatës politike, komuna nuk ka arritur të shpenzojë buxhetin në nivelin e pritur.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Për vitin 2023, komuna ka inkasuar të hyra vetanake në vlerë prej 2,696€, të cilat janë nga taksat administrative, ndërsa komuna ende nuk mbledh të hyra nga tatimi në pronë dhe leje ndërtimi. Komuna gjithashtu ka inkasuar të hyra indirekte nga gjocat e policisë të cilat nuk i ka shpalosur në PVF-të e vitit 2023.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>45,000</b>	<b>45,000</b>	<b>2,696</b>	<b>3,175</b>	<b>4,248</b>
Të hyrat jo tatimore	45,000	45,000	2,696	3,175	4,248

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Në vitin 2022 nuk ishte realizuar auditim por Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2021, ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë të vitit 2023, dy (2) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandim pjesërisht është zbatuar dhe pesë (4) ende nuk janë zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si ato adresohen, shihni Tabelën 4 (ose tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të shtojë kontrollet gjatë përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e lëshuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë kryer të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PFV-ve.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve për të mbledhur të hyrat e tatimit në pronë dhe lejeve ndërtimore për të siguruar fonde nga këto të hyra. Në të njëjtën kohë, Kryetari duhet të fillojë iniciimin për hartimin e Rregullores për tatimet, tarifat dhe taksat, si kosto e shërbimeve komunale.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronikë, përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore, në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pagesat të paguhen brenda afatit të përcaktuar me ligj, që pagat e punëtorëve të planifikohen në buxhet dhe që pagesat të bëhen vetëm kur komuna siguron mjete të mjaftueshme buxhetore për pagesë dhe të rrespektohen afatet ligjore.	Janë ndërmarrë veprime, nuk ka pasur raste.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherë duhet të siguroj që është vënë në përdorim sistemi e-pasuria. Po ashtu, për të pasur një evidencë të saktë të stoqeve, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€, duhet të regjistrohen.	Janë ndërmarrë veprime vetëm regjistrimi të ndërtesave në vlerë 71,065€.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcoj kontrollin lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të sigurojë mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF dhe në PFV në fund të vitit.	Janë ndërmarrë veprime faturat protokollohen dhe janë raportuar faturat e papaguara.	I zbatuar
7.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet komunale i nënshtrohen auditimit të brendshëm për të pranuar një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rezikut dhe proceseve të kontrollit.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.  
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



## Shtojca I: Letër konfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjete Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës Zubin Potok, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- **pajtohem**/nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe (kjo pikë përshtatet nga entiteti).
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Izmir Zeqiri

Kryetar i Komunës Zubin Potok

Data: 25.06.2024



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.